

VENDIM
Nr. 766, datë 26.12.2018

**PËR PUNËSIMIN E STUDENTËVE TË EKSELENCËS NË INSTITUCIONET E
ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL,
PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2019, pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive (specialist dhe të barasvlefshëm), në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, të plotësohen me prioritet nga studentët e ekselencës të diplomuar duke filluar nga viti 2017 e në vijim, nëpërmjet punësimit të tyre me kontratë të përkohshme 1-vjeçare (njëvjeçare). Përfshihen nga ky rregull pozicionet e kësaj kategorie për të cilat legjislacioni specifik përcakton kriteret të posaçme në lidhje me vjetërsinë dhe zotërimin e certifikimeve të ndryshme.

2. Në kuptim të këtij vendimi, me termin “studentë të ekselencës” nënkuptojmë studentët të cilët kanë përfunduar studime universitare në secilin prej cikleve të arsimit të lartë me mesatare 9.00–10.00 ose ekuivalent, në:

- a) institucionet e arsimit të lartë jashtë Shqipërisë;
- b) institucionet e akredituara të arsimit të lartë publik apo institucionet/programet e akredituara të arsimit të lartë jopublik në Republikën e Shqipërisë.

3. Procesi i përzgjedhjes dhe emërimit menaxhohet nga Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil.

4. Departamenti i Administratës Publike shpall publikisht në faqen e tij zyrtare thirrjen për shprehjen e interesit të studentëve të ekselencës që duan të punësohen përkohësisht në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, përkatësisht brenda muajit janar 2019 dhe muajit gusht 2019.

5. Shpallja publike për shprehjen e interesit sipas pikës 4, të këtij vendimi përmban këto të dhëna:

- a) Pozicionet vakante, të grupuara bazuar në kriterin e nivelit dhe llojit të diplomës (fusha e studimit) që kërkon pozicioni i punës;
- b) Dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
- c) Afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- ç) Mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve;
- d) Datat e daljes së rezultateve;
- dh) Mënyrën e njoftimit dhe të komunikimit me kandidatët.

6. Dokumentacioni duhet të dorëzohet elektronikisht në portalin e rekrutimit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në faqen zyrtare të DAP-it.

7. DAP-i, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit, bazuar në mesataren e studentëve të cilët kanë shprehur interesin sipas pikave 5 e 6, të këtij vendimi, krijon listat përkatëse duke i renditur ata për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 9, të këtij vendimi, dhe për secilin nga grupet e pozicioneve të krijuara mbi bazën e kriterit të nivelit dhe llojit të diplomës që kërkon pozicioni i punës. Studentët, të cilët kanë diplomë të niveleve më të larta se ai që kërkon pozicioni i punës, renditen në të gjitha grupet e pozicioneve të fushës përkatëse të studimit, pavarësisht nivelit të diplomës të kërkuar për grupin përkatës.

8. DAP-i, brenda 24 (njëzet e katër) orëve pas krijimit të listave sipas pikës 7, të këtij vendimi, i publikon ato në faqen e tij zyrtare.

9. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e krijimit të listave sipas pikës 7, të këtij vendimi, DAP-i thërret

studentët të cilët, duke filluar nga ai me mesatare më të lartë brenda grupit përkatës, përzgjedhin pozicionin ku duan të emërohen në mënyrë të përkohshme. E drejta e përzgjedhjes është sipas precedencës, si më poshtë vijon:

a) Studentët e diplomuar në institucionet e arsimit të lartë në një nga vendet anëtare të OECD-së ose BE-së;

b) Studentët e diplomuar në institucionet e akredituara të arsimit të lartë publik në Shqipëri;

c) Studentët e diplomuar në institucionet/programet e akredituara të arsimit të lartë jopublik në Shqipëri dhe studentët e diplomuar në vende të tjera jashtë Shqipërisë, të ndryshme nga vendet e OECD-së ose BE-së.

Diplomat e përfituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Në rastet e studentëve me mesatare të njëjtë, e drejta e përzgjedhjes përcaktohet me short në prezencë të tyre.

11. DAP-i, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i procesit sipas pikës 9, të këtij vendimi:

a) publikon në faqen e tij zyrtare listat e studentëve që kanë përzgjedhur pozicionet e punës;

b) dërgon pranë institucioneve të administratës shtetërore pjesë të shërbimit civil, listat e studentëve të cilët kanë përzgjedhur pozicionet e punës për secilin institucion.

12. Institucionet e administratës shtetërore pjesë të shërbimit civil lidhin kontratat e përkohshme të punës me studentët, sipas listës së dërguar nga DAP-i, e cila respekton përputhshmërinë e nivelit dhe të fushës së studimit me kriterin e nivelit dhe llojit të diplomës për pozicionin respektiv të punës.

13. Në përfundim të kontratës 1-vjeçare të lidhur sipas këtij vendimi, ata që dëshirojnë të bëhen pjesë e shërbimit civil, do t'i nënshtrohen procedurave të konkurrimit sipas legjislacionit të shërbimit civil.

14. Nëse në përfundim të procedurës së përcaktuar në pikën 12, të këtij vendimi, ka ende pozicione të lira të kategorisë ekzekutive të paplotësuar, DAP-i vijon procedurat e plotësimit të këtyre pozicioneve për vitin 2019, sipas legjislacionit të shërbimit civil.

15. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, që:

a) të vërë në dispozicion të Departamentit të Administratës Publike listën e institucioneve/ programeve të akredituara të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe në vazhdimësi sa herë ka ndryshime;

b) të bëjë ekuivalencën e mesatares së studentëve që kanë përfunduar studimet jashtë Shqipërisë, në rast se përdoret sistem i ndryshëm vlerësimi, rast pas rasti, sipas kërkesës së DAP-it.

16. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2019.

KRYEMINISTRI
Edi Rama